

VENDIM
Nr. 416, datë 27.5.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRJETIT TË RI ELEKTRIK 20 kV, FIDERI F2 DHE
FIDERI F4”, NË FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrjetit të ri elektrik 20 kV, fideri F2 dhe fideri F4”, në Fushë-Krujë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 39 399.36 (tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 39 399.36 (tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, në zyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Krujë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË PROJEKTTI
“NDËRTIMI I RRJETIT TË RI ELEKTRIK 20 kV NË FUSHË-KRUJË FIDERI F2 DHE FIDERI F4”

Qarku: Durrës; Bashkia Krujë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: “tokë arë” dhe “truall”

Nr.	Numri i kabinës	Të dhëna për pronësinë							Sip. shpronësimi për kabinën m²	Vlera e shpronësimit në lek/m²	Vlera e shpronësimit për kabinën, në lekë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. e pronës m²				
FSHATI ARRAMERAS ZONA KADASTRALE 1042												
	F2/02	Afrim		Vathi	1042	18/70	arë	6240	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F2/05	Osman		Cela	1042	46/25	arë	1490	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F2/07	Bashkëpronarët Stafuka			1042	48/49	arë	9835	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
FSHATI LARUSHK ZONA KADASTRALE 2385												
	F2/10	Selman		Caca	2385	76/5	truall	200	9.24	490	4527.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
FSHATI HALIL ZONA KADASTRALE 1921												
	F4/01	Muharrem		Selimi	1921	22/7	tokë bujqësore e zënë me pemë frutore (nuk preken dru frutorë)	1500	9.24	296	2735.04	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/03	Bashkëpronarët		Halili	1921	26/12	arë	539	9.24	296	2735.04	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/06	Kujtim	Sefer	Seferi	1921	120/10	arë	3400	9.24	296	2735.04	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
FSHATI ARRAMENAS ZONA KADASTRALE 1042												
	F4/13	Rexhep		Hithi	1042	299/6	arë	13370	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/16	Sami	Haki	Stafuka	1042	364/18	arë	1700	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/17	Dashamir		Cela	1042	138/1	arë	4000	9.24	318	2938.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
FSHATI LARUSHK ZONA KADASTRALE 2385												
FSHATI ZEZE ZONA KADASTRALE 3908												
	F4/23	Xhavit	Shaban	Kurti	3908	49/12	arë	2800	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/24	Hasan	Muharrem	Stafuka	3908	42/7	arë	11500	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Rrahman		Rraja	3908	42/26	arë	3000	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
FSHATI NIKEL ZONA KADASTRALE 2795												
	F4/27	Shyqyri	Petrit	Xhametaj	2795	34/14	arë	2100	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/29	Servet		Çangu	2795	97/44	arë	2555	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	F4/32	Bajram		Brama	2795	184/1	arë	2300	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, në seksionin E të kartelës së pasurisë ka shënimin “Në favor të Raifeisen Bank sh.a.”
Vlera totale e shpronësimit									147.84		39,399.36	